

Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen



Raport Mujor Shkurt 2024

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Shoqëria Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	LEK
Vlera fillestare e kuotës	1,000
Shuma fillestare minimale	1,000
Shuma minimale pasuese	1,000
Komision në hyrje	0%
Komision në dalje	0%
Penalite ne rast terheqje te parakohshme	Sipas rregullores se AMF-se
Komision Administrimi ne vit	1.50%
Kosto per transferte fondesh nga pale te treta	Referojuni informacionit ne degjet e RBAL

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Fondi i Pensionit Privat është një mënyrë alternative kursimi, e përdorur ekskluzivisht për kursime afatgjata për vitet pas largimit përfundimtar nga puna. Ky fond zotërohet bashkërisht nga anëtarët e fondit dhe menaxhohet nga Shoqëria Administruese Raiffeisen Invest sh.a, në bazë të kontratës së lidhur me anëtarët e fondit.


Asetet e Fondit do të investohen sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për pension dhe riskut të marrë përsipër.

Fondi synon të ndërtojë një portofol të përbërë kryesisht nga tituj borxhi te emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me maturim afatgjatë (me maturim më të lartë se një vit).

Profili i Rikut dhe Përfitimit

Risk i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë
Përfitimet tipike më të larta



Fondi është në kategorinë e parë të Profilit të Riskut dhe Përfitimit, pra në kategorinë me risk më të ulët.


Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes së luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk. Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 29.02.2024

Vlera Neto e Aseteve	1,433,062,434
Numri i investitoreve	3,955
Cmimi i Kuotes	2,160.9625
*Kthimi vjetor nga investimi (28.02.2023 – 29.02.2024)	4.53%

*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit të investimeve në 29 Shkurt 2024



Në kuader të politikës së investimit të fondit të Pensionit, investimet do të kryhen kryesisht në bono thesari dhe obligacione, të emetuara në tregun primar, duke patur parasysh që aktiviteti i tregimit të titujve të borxhit të emtuar nga Qeveria shqiptare në treg sekondar është i kufizuar.

<i>Instrumenti</i>	<i>Ne % të Aseteve të Fondit</i>
Obligacione Thesari	99.82%
Depozita / Llogari rrjedhese	0.18%

Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy here në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një here në muaj; 7 dhe 10 vjeçare janë me të rralla, afërsisht një here në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një here në 2 muaj për secilin maturitet. Strategjia e investimeve vazhdon të jetë e fokusuar në investime afatgjate.

Vlera neto e asetëve të fondit është rreth LEK 1.43 miliard në datë 29 Shkurt 2024.


Zhvillimet dhe ecuria e normave të interesit të titujve të Qeverisë Shqiptare gjatë muajit Shkurt

Asetet e Fondit Pension janë të investuara në bono dhe obligacione të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe për këtë arsye fondi është i ekspozuar ndaj ndryshimeve në normat e interesit të këtyre titujve. Investimet impaktohen kryesisht nga zhvillimet në tregun e brendshëm sic janë ndryshimet në normat e interesit të titujve të Qeverisë Shqiptare.

Normat e interesit të titujve të emtuar nga Qeveria Shqiptare kanë ndjekur një trend mikës gjatë muajit Shkurt, por pa ndryshime të mëdha. Yieldi i Bonos të Thesarit 12-mujore rezultoi në 3.628%, në të njëjtin nivel me ankandin e muajit Janar.

Yieldi i obligacionit 2 vjeçar rezultoi ne 4.23% dhe yield i obligacionit 7 vjeçar rezultoi ne 5.98%. Rritja mujore ishte vetem 0.02% per te 2 maturitetet. Ndersa yieldet e obligacioneve reference 3 dhe 5-vjeçar rezultuan ne 4.913% dhe 5.573% duke rene perkatesisht me 0.14% dhe 0.05% krahasuar me ankandet e fundit. Gjithashtu yield i obligacionit 15 vjeçar pesoi renie me 0.04% duke rezultuar ne 7.94%.

Grafiket me poshte japin nje pasqyre te ecurise se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te thesarit te emetuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjeçare Shkurt 2023 – Shkurt 2024. Per obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare jane paraqitur yield-et fikse te perllogaritura nga kuotimet e kontributoreve ne fund te muajit Shkurt.




Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri në 29 Shkurt 2024

Kthimi vjetor neto i fondit është 4.53% per periudhen 28 Shkurt 2023 – 29 Shkurt 2024;

Çmimi i kuotes se Fondit te Pensionit ka ndjekur nje trend rrites dhe vlere e kuotes eshte rritur me +0.36% gjate muajit Shkurt. Kthimi i fondit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut, sic jane ndryshimet ne normat e interesit te titujve te Qeverise.


Rritja e normave te interesit te titujve te Qeverise do te ndikojë pozitivisht ne performancen e fondit te Pensionit, i cili mund te investoje me norma me te larta duke rritur kthyeshmerine e portofolit te investimit ne te ardhmen.

Ecuria e çmimit të kuotës Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen



Ne 29 Shkurt 2024	1 Vit	3 Vjet	5 Vjet	7 Vjet	8 Vjet	10 Vjet	Qe nga lancimi i fondit (31 Dhjetor 2010)
Ne % kthim vjetor i periudhes (p.a.)	4.53%	4.33%	4.41%	4.76%	4.95%	5.32%	6.02%

Kthimi vjetor historik i Fondit te Pensionit Privat Raiffeisen per çdo vit



Anetaret e fondit te Pensionit keshillohen te jene nje horizont sa me te gjate qendrimi ne fond (mundesisht deri ne moshen e pensionit, pese vjet para moshes se percaktuar ne Ligj) per te perfituruar nje kthim maksimal nga investimi, per te permiresuar standartin e jeteses ne moshen e pensionit dhe per te evituar penalitetet ne rast terheqje te parakohshme.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjere numerike, jane perdorur per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investoret per te nxjerre konkluzione per te ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitese e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit. Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha, në web site www.raiffeisen-invest.al, ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.